



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:189602
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05492077

Ac.nr.8323/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Fatmir Baloku dhe Halide Reka, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësve J.S., dhe H.S., që të dy nga fshati B....., Komuna e Suharekës, të cilët me autorizim i përfaqëson Bajram Kryeziu avokat nga Suhareka, kundër të paditurve M.E., V.E., dhe L.E., të gjithë nga fshati B....., Komuna e Malishevës, të cilët me autorizim i përfaqëson B.K., avokat nga Malisheva, për kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i autorizuari i paditësve, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, C.nr.381/2013, të datës 02.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e themeltë ankesa e paditësve J.S., dhe H.S., që të dy nga fshati B....., Komuna e Suharekës, **anulohet** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Malishevë, C.nr.381/2013, të datës 02.11.2022, dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin ankimor C.nr.381/2013, të datës 02.11.2022, në pikën një të dispozitivit e ka hedhur poshtë si të palejueshme padinë e paditësve J.S., dhe H.S., nga fshati B....., Komuna e Suharekës, e parashtruar kundër të paditurve M.E., V.E., dhe L.E., të gjithë nga fshati B....., Komuna e Malishevës. Në pikën dy e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësve ndaj të paditurit S.E., nga fshati B....., Komuna e Malishevës. Në pikën tre e ka konstatuar të tërhequr tërhequr kundërpadinë e të paditurit S.E., nga fshati B....., Komuna e Malishevës e parashtruar kundër paditësve J.S., dhe H.S., nga fshati B....., Komuna e Suharekës.

Në pikën katër ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore veç e veç.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë ka parashtruar i autorizuari i paditësve, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj të bazuar ankesën e paditësve aktgjykimin ankimor ta prish dhe çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurve, me përgjigje në ankesë ka propozuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar, ndërsa aktvendimi ankimor të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

- **Ankesa është e themeltë**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë parashtruar padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurve për kompensim dëmi.

Nga ana tjetër të paditurit M., V., dhe L.E., përmes përgjigje në padi e kanë kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar dhe nga fakti se kërkesa është e parashkruar. Ndërsa i padituri S.E., e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve sepse me asnjë dëshmi nuk vërtetohet kërkesa e paditësve në raport me të.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të padisë së paditësve si dhe të deklarimeve të autorizuarit të paditurve lidhur me parashkrimin e kërkesëpadiisë të paraqitura në seancën e shqyrtimit përgatitor, me aktvendimin C.nr.381/2013 të datës 02.11.2022, e ka hudhë poshtë si të palejuar padinë e paditësve për shkak të parashkrimit të kërkesëpadiisë së paditësve, duke vendosi më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimi ka theksuar se gjykata nga shkresat e lëndës të bashkangjitura, padisë dhe provave, vërtetoi faktin se paditësit padinë e kanë parashtruar me datë 24.09.2013, ndërsa shkaktimi i dëmit jo material rezulton me datë 29.01.2010, del se kërkesa e paditësve është e parashkruar sipas nenit 376, lidhur me nenin 377 të LMD-së, të vitit 1978, ligj i cili ishte në fuqi në periudhën e krijimit të dëmit, duke qenë se në rastin konkret shkaktimi i dëmit rrjedh nga vepra penale. Vendimin e ka bazuar në dispozitat e nenit 38, nenit 391.pika (f) dhe nenit 404 par.1 dhe 2 të LPK-së. Ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit nuk mund t'i pranojë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore

nga neni 182.1 lidhur me nenin 391 pika f) të LPK-së, meqenëse është hedhë poshtë padia pa u plotësuar kushtet e përcaktuara sipas nenit 391 pika f) të LPK-së.

Duke e shqyrtuar aktvendimin në kufijtë e pretendimeve ankimore, Gjykatës së Apelit i rezulton e bazuar ankesa e paditësve, me të cilat atakohet aktvendimi, për shkak se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka hedhë poshtë padinë e paditësve, me pretendimin se padia e tyre është e parashkruar, sipas prapësimit të së paditurve, i icili është prapësim materialo-juridik, për të cilën gjykata duhet të vendosë meritorisht, ndaj në situatë të tillë gjykata e shkallës së parë nuk është dashur që ta hedhë padinë, por të veprojë sipas padisë, në rast se plotësohen kushtet ligjore e njëjta mund të vendosë konform neni 152 lidhur me nenin 399 të LPK, në rast se nuk ka pengesa për vendosje, apo nëse vlerëson ndryshe e njëjta mund të caktojë seancën përgatitore apo drejtpërdrejtë seancën kryesore dhe pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të vendosë drejtë duke e zbatuar të drejtën materiale.

Për këto arsye, Gjykata e Apelit e vlerëson si të duhur prishjen e një vendimi të tillë gjyqësor, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës që i njëjti përmban. Me qëllim të eliminimit të tyre pas marrjes së lëndës në rigjykim dhe rivendosje, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që të veprojë sipas vërejtjeve të kësaj gjykate të shkallës së dytë, të vendosë duke u bazuar në dispozitat ligjore duke dhënë arsye të mjaftueshme për të gjitha vendimet e marra në dispozitiv të aktvendimit apo aktgjykimit që nxjerrë, përfshirë këtu edhe për shpenzimet e procedurës.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 208 dhe 209, paragrafi 1, pika (d) të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.8323/2022, më datë 21.03.2024

Kryetare e kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.